

Bazuar në Urdhërin nr. 7961 Prot., datë 25.11.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore “Për hapjen e procedurës së rekrutimit të personelit, nëpërmjet konkurimit të hapur” Instituti i Sigurimeve Shoqërore, bën shpalljen e vendit të lirë të punës për pozicionin:

DRSSH Korçë / ALSSH Pogradec

1. Përgjegjës Agjencie

Kandidati konkurues

- Duhet të zotërojë Diplomë në nivel Master profesional ose të barazvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë në Shkenca Ekonomike, Juridike, Administrim Publik, Shkenca Sociale;
- Të ketë të paktën 3 vjet eksperiencë në fushën e administratës publike dhe/ose në një nivel të mesëm menaxhimi në institucione private;
- Të ketë eksperiencë pune mbi 2 vjet në nivel specialist për punonjësit, brenda administratës së sigurimeve shoqërore, si dhe / ose jo më pak se 2 vjet në administratë publike/shërbim civil, të një kategorie të barazvlefshme me kategorinë e specialistit apo në sektorin privat, në nivel menaxhimi, në profesion.

Kandidati që konkuron duhet të plotësojë kërkesat si më poshtë:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore, shërbimi civil ose administrata publike, që nuk është shënuar, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet testimi me shkrim & intervista

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuritë në fushën e sigurimeve shoqërore (statusi i ISSH-së, Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar);
- Njohuri të Rregulloreve të përfitimeve, kontributeve, financiare, personelit dhe për sistemin e informacionit të ISSH;
- Njohuri të Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat";
- Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë;
- Njohuri të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- Njohuri të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
- Njohuri të Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Në vlerësimin e kandidatëve, përfshihen:

- a) vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve: që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën;
- b) vlerësimi me shkrim: që konsiston në vlerësimin e njohurive për legjislacionin e zbatueshëm për sigurimet shoqërore, organizimin administrativ në sistemin e sigurimeve shoqërore, për nivelin e njohurive akademike dhe profesionale, bazuar në kriteret e përcaktuara;
- c) intervista me gojë, ku zhvillohet intervistimi i kandidatëve, i cili synon të evidentojë formimin e përgjithshëm, si dhe vizionin e tyre mbi veprimtarinë e sigurimeve shoqërore dhe për pozicionin që konkurohet.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, deri në 20 pikë;
- b) për intervistën me gojë, deri në 40 pikë;
- c) për vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë.

Kandidati konkurues kualifikohet nëse në total ka fituar mbi 70 pikë, nga 100 pikë të mundshme, gjatë fazës së vlerësimit.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat me postë, në zyrën e protokollit të ISSH-së, si më poshtë:

- Një kërkesë për konkurim për pozicionin e punës për të cilin janë të interesuar;
- Një kopje të jetëshkrimit (CV);
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave (e noterizuar);
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- Raport të aftësisë për punë
- Fotokopje të librezës së punës;
- Certifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme;
- Fotokopje të Kartës së identitetit.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave me postë, duhet të bëhet brenda datës 09.12.2022, pranë zyrës së prokoll/sekretarisë në ISSH.

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më lart.

Testimi me shkrim do të zhvillohet në ambjentet e ISSH-së në datën **20.12.2022, ora 10.00**

Intervista me gojë do të zhvillohet në ambjentet e ISSH-së në datën **22.12.2022, ora 10.00**